

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“DRONE REVOLUTION” SHPK

Ortaku themelues i Shoqërisë :

- **Z. Stefano DE RUBIS** , atesia Antonio shtetas Italian , dtl. 25.06.1958 lindur në Rome Itali dhe me banim ne Rome rruga Luigi GASTINELLI nr. 226 i identifikuar me ID Nr. YB0644182;

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”,

mbledhur në Tiranë sot më datë 24.10.2018,

VENDOSI:

Të krijojë një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim hartoi dhe miratoi këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1.

Emri

1.1 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj " **DRONE REVOLUTION** " sh.p.k.

1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të saj.

NENI 2

Forma juridike

2.1 Shoqëria tregtare “**DRONE REVOLUTION**”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

2.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakut sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.

NENI 3

Selia

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Rrugen Hysen Zaloshnja, Nd.2, Hyrja 4, Ap.16, 1022, Njesia administrative 5

3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të vetëm të Shoqërisë.

3.3 Me vendim të Asamblesë të Ortakut të vetëm të shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

NENI 4 Vula e shoqërisë

4.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj.

4.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e ortakut të vetëm në përputhje me legjislacionin shqiptar;

NENI 5 Objekti i Veprimtarisë

5.1 Shoqëria ka si objekt veprimtaritë si më poshtë:

- **Administrim dhe autonomi me kapacitet aeronavigacion në distanза të shkurter filmime me solucion të lartë (aero/dron) në shërbim public dhe privat në cdo ambient, hapësirë, banesë, fushe male. Ndërtim, bujqësi, peshkim, turizëm e siguri publike.**

5.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

NENI 6 Kohëzgjatja e Shoqërisë.

6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje për një afat të pacaktuar.

6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 7 Kapitali i shoqërisë dhe Kuotat

7.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100.000 lekë.

- **Z. Stefano DE RUBIS**, zotëron një kuotë me vlerë 100.000 (nëntëmijë) lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

7.2 Ortaku, në bazë të kërkesës së organit administrues, mund të sjellin para në shoqëri sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortaku në

formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjeshtëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që ortakët zotërojnë.

7.3 Nëse mes palëve nuk ka akorde specifike, financimet në formë huaje të bëra nga Ortaku do të konsiderohen si hua pa interes.

NENI 8 **Organet e Shoqërisë**

8.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

8.2 Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 9 **Administratori**

9.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

9.2 Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z. Stefano DERUBIS**

NENI 10 **Dispozita të fundit**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Përsa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit, dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

NENI 11 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt themelimi përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore, njëra nga të cilat qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

Stefano DERUBIS

